

Raport mbi Sondazhin

Për Marrëdhëniet Shqiptaro - Greke

Tiranë, 22 Nëntor 2024

Opinionit Publik Shqiptar mbi Greqinë, Grekët dhe marrëdhëniet Shqiptaro – Greke

Sondazhi për marrjen e opinionit të publikut shqiptar mbi Grekët, Greqinë dhe marrëdhëniet Shqiptaro – Greke, u realizua nga Albanian Center for Good Governance me mbështetjen e Fondacionit “Konrad Adenauer”. Ky kërkim u zhvillua nga data 1 – 7 Nëntor 2024 duke u shtrirë pothuajse në të gjithë vendin. I planifikuar për të pyetur 915 persona, ai u realizua me 905 njerëz, të cilët shprehën predispozicionin për t’iu përgjigjur pyetjeve të Sondazhit.

Qëllimi kryesor ka qenë marrja e një kampioni sa më të plotë dhe gjithpërfshirës, pa një selektim paraprak, por me takime rastësore me qytetarët e ndryshëm në rrugë dhe në banesat e tyre. Të gjitha intervistat janë bërë face to face dhe me bashkëbisedim të lirë mes intervistuesve dhe të intervistuarve. Sondazhi u zhvillua në një klimë të relaksuar emocionale, sepse një nga vatrat e diskutimeve publike për marrëdhëniet dypalëshe, çështja Beleri, kishte marrë zgjidhje. Nga të dhënat kryesore, që dalin nga ky sondazh, mund të nënvizojmë:

1. Vlerësimi për marrëdhëniet dypalëshe mes Shqipërisë dhe Greqisë

Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Greqisë duken të qëndrueshme dhe pozitive. Për shumicën absolute të të pyeturve, marrëdhëniet aktuale mes dy vendeve fqinje janë të mira dhe shumë të mira (45 %), ndërkohë që për një pjesë të madhe (41%) duken normale. Janë një pakicë shumë e vogël, rreth 13 %, që mendojnë se këto marrëdhënie nuk janë të mira.

Për pjesën dërrmuese të të pyeturve, (77 %), konsiderohet si shumë e rëndësishme mbajtja e marrëdhënieve të mira me Greqinë. Vetëm një pjesë e vogël, (9%) nuk e konsiderojnë me rëndësi mbajtjen e marrëdhënieve të mira me Greqinë. Pavarësisht problematikave që shpesh herë ekzistojnë në marrëdhëniet dypalëshe, siç ishte debati rreth rastit “Beleri”, vihet re se në marrëdhëniet mes dy vendeve ka qëndrueshmëri dhe treguesit janë pozitiv edhe në raport me perspektivën e këtyre marrëdhënieve.

2. Çështja “Çame” dhe ndikimi i saj në raportet me Greqinë

Ishte shumë interesante marrja e një opinioni të gjerë nga qytetarët e ndryshëm mbi temën për Çamërinë, Çamët dhe pronat e tyre si dhe për të parë ndikimin e kësaj çështjeje në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Greqisë. Kjo temë ka qenë herë pas here prezente në debatet publike e politike në Shqipëri si dhe ka një parti politike që deklaroi se përfaqëson interesat e këtij grupimi.

Shumica e atyre që janë pyetur nëse kanë informacion mbi Çamët dhe pronat e tyre në Greqi, janë përgjigjur pozitivisht (73%), kundrejt 20%, që thanë se nuk kanë informacion dhe nuk kanë dijeni për këtë çështje. Madje ka edhe një përqindje të vogël, që nuk është përgjigjur as po e as jo. Një pjesë e madhe (53%) e të pyeturve e shohin këtë çështje si një pengesë në zhvillimin e marrëdhënieve më të mira mes dy vendeve. Kjo shihet sidomos në përgjigjet që kanë dhënë personat mbi moshën 50-vjeçare.

3. Çështja e “Vorio Epirit”

Ndryshe nga ndjeshmëria dhe njohuritë për çështjen e çamëve dhe pronave të tyre në Greqi, tema e “Vorio Epirit”, si pretendim i retorikës që vjen nga Greqia, nuk ka të njëjtën përmasë njohjeje. Mund të themi se me një mesatare 50 % me 50 % ndahen ata që kanë njohuri (informacion) lidhur me çështjen e Vorio-Epirit me ata që nuk kanë dijeni.

Tema e Vorio-Epirit, në opinionin e gjerë publik shqiptar, është parë dhe konsideruar si pretendim territorial i Greqisë, si retorikë nacionaliste që pretendon aneksim të jugut të Shqipërisë brenda territorit aktual grek. Kjo temë është bërë shpesh herë “mollë sherri” në trajtimin e marrëdhënieve mes dy vendeve tona. Ish-partia “Agimi i Artë”, artikuloi gjerësisht retorikën nacionaliste mbi “Vorio Epirin”.

Në anën tjetër, shqiptarët nuk i kanë kushtuar rëndësi kësaj teme dhe e kanë konsideruar si një atavizëm të nacionalizmit, që herë pas here gjendet aty këtu nëpër Ballkan e Greqi. Mund të themi se, pak a shumë, të dyja çështjet; ajo e çamëve dhe e Vorio-Epirit, kanë zënë pothuajse të njëjtën hapsirë interesimi në opinionin e gjerë publik, me një përqindje pak më të lartë vëmendja dhe njohuria për problemin e çamëve.

4. Rasti “Beleri”..

Në kohën që është bërë ky sondazh, diskutimet dhe debatet për ish-kryebashkiakun e zgjedhur të Himarës, Fredi Beleri, pothuajse ishin mbyllur. F. Beleri, ishte me mandatin e ri të Eurodeputetit dhe pak ditë para se të fillonte ky Sondazh, ai ishte zyrtarisht në Tiranë bashkë me një grup eurodeputetësh. Kryeministri Rama refuzoi ta takonte dhe e anashkaloi nga protokollin, ndonëse shkëmbyen mesazhe në distancë nëpërmjet medias. Disa ekstremistë qëlluan me vezë dhe miell zotin Belerin në dalje të njërit prej takimeve zyrtare.

Të dhënat e sondazhit, tregojnë se e gjithë saga gjyqësore me të cilën u përball Beleri, ka lënë gjurmë në kujtesën e qytetarëve të thjeshtë. Mbi 50 % janë shprehur se kanë dijeni për çështjen “Beleri”. Disa “kanë shumë dijeni”, disa “jo aq shumë”, por që në thelb, kanë informacion dhe kanë ndjekur zhvillimet rreth këtij rasti, që nisi në më 12.05.2023, ditën e arrestimit me akuzën për blerje votash në Himarë.

Pavarësisht debateve dhe retorikës politike që ka përcjellë këtë rast, shqiptarët mendojnë se “Rasti Beleri”, nuk mund të konsiderohet si “çështje e rëndësishme” në marrëdhëniet mes dy vendeve. Ata duket se e konsiderojnë gjithnjë e më shumë si një rast politik të izoluar, që nuk lidhet me klimën e përgjithshme të marrëdhënieve me minoritetin grek në Shqipëri.

Shumica e të pyeturve mendojnë se, përtej këtij rasti, “ka çështje (të tjera) më të rëndësishme” (52%) në marrëdhëniet mes dy vendeve. Vetëm 17 % e të pyeturve e konsiderojnë këtë rast si “çështjen më të rëndësishme në marrëdhëniet mes dy vendeve”. Rreth 30% e konsiderojnë këtë si “çështje të parëndësishme” në marrëdhëniet mes dy vendeve.

Një pikë tjetër lidhur me këtë rast, ishte përgjigja e pyetjes se sa është mbuluar çështja Beleri nga ana e mediave shqiptare. Duket qartë se, një mazhorancë e konsoliduar e të pyeturve, janë shprehur se media e ka mbuluar/ trajtuar/raportuar “shumë” (45%) rastin Beleri, kundrejt 16% që thonë “pak”. Në fakt, çështja Beleri, përtej debateve për respektimin e të drejtave dhe lirive të minoriteteve në Shqipëri, ishte për një vit, një nga debatet e ashpra politike mes opozitës së djathtë dhe mazhorancës së majtë. Mazhoranca u akuzua se në rastin “Beleri” ka përdorur standart të dyfishtë të trajtimit të rastit dhe se ka patur prapavijë diplomatike për të provokuar marrëdhëniet e mira me Greqinë. Kryeministri Rama, njihet për marrëdhëniet e tij “vëllazërore” me Turqinë dhe qasja e tij personale, por edhe institucioneve të drejtësisë në rastin Beleri, janë konsideruar shpesh si shkelje syri për Turqinë..

5. Vlerësimi për sistemin e drejtësisë

Që prej vitit 2016, Shqipëria po përpiqet të ngrejë një sistem të ri drejtësie, duke përdorur mekanizmin e “vetingut” për gjyqtarët e prokurorët dhe duke synuar një efektshmëri më të madhe në dhënien e drejtësisë dhe luftën kundër krimit e korrupsionit. I vënë në kuadrin e kësaj drejtësie në tranzicion, mund të konsiderohet edhe trajtimi i rastit Beleri nga këndvështrimi juridik. Megjithatë, shqiptarët e pyetur, janë përgjigjur në pyetjen se sa të pavarur dhe të paanshëm e shohin sot sistemin e drejtësisë, pa përmendur raste specifike.

Në përgjithësi, duket ende qartë një skepticizëm dhe mungesë besimi se drejtësia në Shqipëri është “e pavarur dhe e paanshme”. Mbi 41% vlerësojnë se “drejtësia nuk është as e pavarur dhe as e paanshme”. Vetëm 22% besojnë se ajo është “edhe e pavarur edhe e paanshme”. Fasha gri e përgjigjes me “ndoshta”, tregon përqindjen e lartë të popullsisë, e cila ende pret vepra konkrete nga ana e drejtësisë, e cila ende nuk është në nivelin e pritshmerivë të qytetarëve.

Reformat që janë ndërmarrë në kuadër të reformimit dhe efikasitetit të drejtësisë, nuk kanë sjellë gjithmonë dobi për qytetarët dhe sidomos për ata që janë në zona periferike. Qeveria ka përdorur mekanizma juridikë për të zgjatur duart e saj drejt administrimit të drejtësisë. Për shembull; të gjithë qytetarët shqiptarë, janë të detyruar të marrin drejtësi në shkallën e dytë në Apel vetëm në një derë, në Gjykatën e Apelit në Tiranë. Në këtë gjykatë, jo vetëm është shtuar burokracia, vonesat në trajtimin e dosjeve, por është rritur edhe tarifa e korrupsionit!

Qeveria refuzoi propozimin e avokatëve dhe ekspertëve për ta ndarë këtë gjykatë së paku në rajone dhe jo për ta mbledhur të gjithën në Tiranë. Kjo çështje meriton një kërkim më të detajuar, për të

parë se sa kanë përfituar realisht shqiptarët nga drejtësia e re dhe a vazhdon ajo të mbetet nën kontrollin e politikës.

6. Vlerësime të tjera mbi raportet shqiptaro – greke

a) Kontributi i shqiptarëve emigrant në ekonominë e Greqisë

Që nga viti 1991 e në vazhdim, mijëra shqiptarë kanë emigruar në Greqi, duke qëndruar atje në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Valët shqiptare të emigrimit në Greqi kanë prekur pothuajse gjithë territorin e Greqisë dhe moshat e ndryshme të emigrantëve, meshkuj e femra, kanë kryer punë në të gjitha profesionet dhe llojet e punëve. Të pyetur rreth kontributit të emigrantëve shqiptarë në zhvillimin e ekonomisë së Greqisë, 96 % bien dakord që “emigrantët shqiptarë kanë kontribuar në zhvillimin e ekonomisë së Greqisë”. Ky përcaktim është i qëndrueshëm pothuajse njësoj në të gjitha qytetet ku është zhvilluar sondazhi.

b) Pozita e minoritetit grek në Shqipëri

Të pyetur nëse janë “dakord që qeveria shqiptare respekton të drejtat e minoritetit grek në Shqipëri”, shumica e qytetarëve e kanë thënë miratimin e tyre. Pra, për 79% të të pyeturve, “qeveria shqiptare respekton të drejtat e minoritetit grek në Shqipëri”. Vihet re se në disa zona ku ka pak më shumë minoritarë, si në Dervician, Himarë, Përmet apo Korçë, kjo përqindje është pak më e ulët dhe kjo tregon se në nivel lokal, ka ende pretendime për një trajtim më të mirë të minoritarëve grekë.

Për shumicën e shqiptarëve (78%), minoriteti grek në Shqipëri “nuk përbën kërcënim”. Një pakicë e vogël, kryesisht në rajonet kufitare me Greqinë, ka një skepticizëm më të madh. Por në tërësi, minoritetit grek në Shqipëri nuk shihet si kërcënim.

c) Ndihma e Greqisë për Shqipërinë

Një seksion interesant në këtë sondazh ishte marrja e vlerësimit të qytetarëve lidhur me ndihmën që Greqia i ka dhënë Shqipërisë në këto 20 vitet e fundit. Në fakt, ndihma emergjente që Greqia i ka dhënë Shqipërisë nga viti 1991 – 2001 ka qenë e lidhur me hapjen e portave që ajo u bëri emigrantëve shqiptarë për të punuar dhe për të sjellë remitanca në vendin e tyre.

Kushtet ekonomike të Shqipërisë nga viti 2000 e në vazhdim kanë ardhur duke u përmirësuar dhe, sidomos në vitin 2008 kur Greqia hyri në krizë ekonomike, shumë sipërmarrës të vegjël shqiptarë, lanë Greqinë dhe erdhën në Shqipëri. Mirëpo, gjithësesi, marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve janë dominuar nga roli që kanë luajtur emigrantët.

Në një vlerësim të përgjithshëm lidhur me ndihmën e Greqisë për Shqipërinë në 20 vitet e fundit (ku mund të përfshihet akomodimi/mikpritja e emigrantëve dhe ndihmar e tjera shtetërore), shumica e qytetarëve (68%) bien dakord se Greqia e ka ndihmuar Shqipërinë, kundrejt 31% që nuk janë dakord me këtë konstatim

d) Vullneti i grekëve për anëtarësimin e Shqipërisë në BE

Është shumë interesante e dhëna e marrë lidhur me perceptimin që kanë shqiptarët për qasjen e grekëve në raport me anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Pavarësisht vlerësimit pozitiv që i bëjnë “ndihmës greke” në këto 20 vitet e fundit, opinioni ndahet pothuajse përgjysmë kur vjen fjala tek vlerësimi i dëshirës që kanë grekët për ta parë Shqipërinë në BE. 49.94% shprehen dakord me konstatimin se “grekët nuk duan që Shqipëria të bëhet anëtare e BE”, kundrejt 50.06%, që janë kundër këtij konstatimi dhe nuk besojnë se grekët janë kundër anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Ky hendek mosbesimi ka nevojë të qartësohet dhe ndoshta kjo duhet të nisë nga një qasje më pro-aktive e Greqisë tek mediat në Shqipëri për të informuar më mirë për mbështetjen që ky vend i bën aspiratës së Shqipërisë për integrim në BE. Deklaratat e Kryeministrit Mitcotakis gjatë procesit të Belerit, ndoshta janë një nga ato qëndrime që kanë lënë gjurmë në memorien e shqiptarëve të thjeshtë, të cilët kanë shprehur skepticizëm. Përmendja e “veto”-s, mund të konsiderohet njëri nga faktorët që ka ndikuar në këtë perceptim.

e) Integrimi i fëmijëve të emigrantëve shqiptarë në shoqërinë greke

Një nga çështjet e adresuara në këtë sondazh ishte vlerësimi i opinionit të qytetarve lidhur me integrimin e plotë në shoqërinë greke të fëmijëve të emigrantëve të lindur në Greqi. Prej vitit 1991 e në vazhdim, janë me miëjra fëmijë të lindur dhe rritur në Greqi si dëmijë emigrantësh dhe natyrshëm vjen pyetja se sa janë integruar ata në shoqërinë e vendit ku jetojnë. 86% e të pyeturve janë shprehur se bien dakord me konstatimin se “fëmijët e emigrantëve janë integruar plotësisht në shoqërinë greke”. Ky vlerësim duket i qëndrueshëm, sepse siç do të shohim në vijim, rreth 80 % e të pyeturve janë shprehur se kanë “një të afërm ose emigrant në Greqi”. Pra, vlerësimi bëhet mbi njohuri dhe informacion të konfirmuar.

7. Marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve

Si dy vende fqinje, Shqipëria dhe Greqia kanë zhvilluar marrëdhënie ekonomike të qëndrueshme, duke filluar nga viti 1992 e deri më sot. Në sondazhin e zhvilluar, shqiptarët u pyetën për të marrë prej tyre vlerësimin se cilin vend shohin ata “më shumë përfitues” dhe cilin “më pak përfitues”. Nga të dhënat del se shumica e qytetarëve besojnë se nga këto marrëdhënie kanë përfituar “të dyja njësoj” (45%), ndërkohë që vlerësohet se midis Shqipërisë dhe Greqisë, ajo që ka “përfituar më shumë” është Greqia (36%). Një përqindje shume e vogël, rreth 2% mendojnë se në këto marrëdhënie “ka përfituar vetëm Shqipëria”.

Në vijim të këtij opinioni, theksohet se është Greqia ajo që u favorizua më shumë në marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve që nga vitit 1991. Janë 51% e të pyeturve ata që mendojnë se Greqia u favorizua më shumë, në raport me 11% që mendojnë se u favorizua Shqipëria. Por, edhe këtu, janë 35% e të pyeturve që mendojnë se janë favorizuar të dyja.

8. Qëndrimi personal ndaj grekëve në Greqi

Në këtë kërkim, ACGG u interesua për të mbledhur një opinion të përgjithshëm mbi qasjen individuale që të intervistuarit kanë në raport me grekët. Në Korçë dhe në Sarandë, dy vende kufitare me Greqinë, bie në sy përqindja (18%) e lartë e qëndrimit negative ndaj grekëve. Shumica e të pyeturve, 46 % kanë vlerësim pozitiv për grekët dhe në vijim të kësaj, janë edhe 40% që kanë

qëndrim “as pozitiv dhe as negative”. Kjo qasje neutraliteti shtrihet pothuajse në të gjitha qytetet, por bie në sy që fasha e moshës së re (18-25 vjeç) ka më shumë skepticizëm në raport me qasjen pozitive ndaj grekëve.

9. Marrëdhëniet me minoritetin grek në Shqipëri

Lirisht mund të konstatohet se në tërësi, rreth 80 % e të pyeturve janë shprehur se shqiptarët “kanë marrëdhënie shumë të mira dhe të mira” me minoritetin grek. Janë vetëm 1.2% e të pyeturve ata që vlerësojnë se shqiptarët kanë marrëdhënie “të këqija” me minoritetin grek në Shqipëri. Edhe në zonat ku ka më shumë përqëndrim të minoritetit grek, si Derviciani, Himara, Saranda etj, vlerësimi është i lartë për këtë raport të shqiptarëve me minoritarët grekë. Ky perceptim është një tregues shembullor për klimën e përgjithshme në të cilën jetojnë e veprojnë minoritarët grekë në Shqipëri.

Vlen të theksohet fakti që shumica e të pyeturve, rreth 75 %, nuk kanë ndonjë lidhje me etninë greke.

10. Afërsia me emigrantët shqiptarë në Greqi

Gjatë këtij kërkimi, u interesuam të mësojmë se sa prej të pyeturve kanë lidhje familjare, miqësore, shoqërore me emigrant shqiptarë që jetojnë në Greqi. Një mazhorancë shumë e madhe e të pyeturve (80%), treguan se kanë lidhje me persona që janë emigrant në Greqi. Pa specifikuar llojin e këtyre raporteve me ta, ata i konsideruan të afërm e familjarë shumicën e tyre si dhe shokë e miq të afërt. Pra 80% e të pyeturve, së paku kishin njohuri të mjaftueshme për Greqinë dhe lidhjet me këtë vend, nëpërmjet tregimeve të emigrantëve dhe lidhjeve familjare.

11. Perceptime negative dhe pozitive mbi grekët dhe Greqinë

Gjatë zhvillimit të këtij sondazhi, u morën të dhëna interesante mbi disa perceptime negative, pozitive, të vërteta e të pavarteta lidhur me qasjen e shqiptarëve ndaj grekëve dhe Greqisë. Në pyetsor, u përfshinë disa stereotipe të ngulitura në diskursin e zakonshëm dhe në mjedise familjare e shoqërore. Njëkohësisht u konsideruan edhe stereotipe të përcjellë nga media dhe opinioni publik, për shumë teza që lidhen me klimën e marrëdhënieve shqiptaro – greke.

- A) A është e vërtetë që shqiptarët dhe grekët nuk kanë luftuar kurrë kundër njëri – tjetrit? Kjo ishte një pyetje që iu bë qytetarëve në këtë sondazh. Mbi 56% e tyre thanë se nuk është e vërtetë, duke nënkuptuar se shqiptarët dhe grekët kanë luftuar kundër njëri – tjetrit. Janë 43 % e të pyeturve, që theksojnë se, po, është e vërtetë që shqiptarët dhe grekët nuk kanë luftuar kurrë kundër njëri – tjetrit.
- B) Të pyetur nëse Qeveria greke mbështet me të vërtetë integrimin e Shqipërisë në BE, 38% thanë se kjo është e vërtetë. Ndërkohë, një mazhorancë prej 61 %, theksuan se kjo nuk është e vërtetë dhe për to Qeveria greke nuk po e mbështet me të vërtetë integrimin e Shqipërisë në BE.

12. Orientimi politik

Një nga pyetjet e bëra në sondazh, ishte raporti i të intervistuarit me ideologjitë politike që mbështet. Ndonëse në Shqipëri popullsia e zakonshme nuk e ka shumë të qartë dallimin ideologjik

brenda një spektri të caktuar, gjithësesi morëm përgjigje interesante. Siç shihet edhe ne grafik, dy shtyllat kryesore rreth të cilës mblidhen qytetarët është e “E majta”(28 %) dhe “e Djathta 24%), ndërkohë që qasjet e tyre me konceptet e qendrës së majtë apo qendrës së djathtë janë ende të reja. Ajo që bie në sy është përqindja e lartë (37%) e të anketuarve, të cilët nuk e lidhin veten me asnjërin grupim politik. Në një farë mënyre, ky është edhe trendi i pjesmarrjes në zgjedhje, ku një shumicë e madhe nuk shkojnë të votojnë ose edhe nëse shkojnë, votojnë për konjunkturën e momentit dhe jo për bindjet e tyre.

#

#

#